



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 29.01.2025

Nr. 505 prot.

Data: 28.01.2025

Nr: 38

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME NR. 1,
DATË 13.01.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË ORGANIZATËS
QENDRA “QENDRESA QYTETARE”

Sot më datë 28.01.2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Organizata Qendra “Qendresa Qytetare”

SUBJEKT: Z. Rakip Suli, Kryetar i Bashkisë Kamëz

OBJEKT: Konstatimi i përdorimit të burimeve publike

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe pika 2, neni 91, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 1, nënpika 1.3, shkronja “c”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Organizata Qendra “Qendresa Qytetare”, më datë 13.01.2025, ka paraqitur denoncim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail. Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 1, në datën 13.01.2025.

Nga shqyrtimi paraprak i të dhënave që përmban denoncimi si dhe dokumentet bashkëlidhur tij pretendohet si vijon:

Nr: 38

Data: 28.01.2025

Ora: 10:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin nr. 1, datë 13.01.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare”

“Më datë 11 Janar 2025, në ambientet e Bibliotekës së Kamzës është zhvilluar një takim i përfaqësuesve të Partisë Socialiste, duke përfshirë z. Rakip Suli, Kryetar i Bashkisë, Zj. Elisa Spiropali, Zj. Lindita Nikolla, me Kuvendin Rinor të Partisë Socialiste. Ky takim, sikundër rezultoi nga postimet në faqet zyrtare të disa pjesëmarrësve, është kryer për qëllime zgjedhore”.

Më datë 16.01.2025, u vendos fillimi i procedurës administrative.

Nëpërmjet adresës së postës elektronike personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Kamëz, i’u kërkua të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 21.01.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan të gjitha palët në proces për t’u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Të pranishëm në këtë seancë ishin përfaqësuesi i Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare” z. Dhimitër Zguro si dhe përfaqësuesi i Bashkisë Kamëz zj. Klea Shainaj, të cilët mbajtën qëndrimet e tyre dhe dhanë sqarime lidhur me këtë proces hetimor.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes u vendos vijimi i hetimit administrativ.

Nga denoncuesi u pretendua se veprimtaria e kryer përbën shkelje të dispozitave ligjore, pasi përdorimi i ambienteve të një institucioni publik, për qëllime zgjedhore, konsiderohet veprimtari e ndaluar sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 1.3/c, të vendimit 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Kamëz, pretendoi se provat e depozituara si “Skaleta e Takimit”, “Kërkesa për përdorimin e Sallës së Rinisë në Pallatin e Kulturës “Artan Cuku”, drejtuar Bashkisë Kamëz, Rregullorja e Brendshme “Për përdorimin e sallave publike, të Pallatit të Kulturës “Artan Cuku”, si dhe fotot e administruara provojnë se aktiviteti i organizuar nga “Kuvendi Rinor Kamëz”, në ambientet e një institucioni publik nuk ka pasur qëllime zgjedhore elektorale.

Nga hetimi administrativ dhe konstatimet e monitoruesit të caktuar nga KQZ, u provua se veprimtaria publike, është zhvilluar në ambientet e Sallës së Rinisë së Qendrës së Kulturës në Bashkinë Kamëz, sikurse provohet nga raporti i monitorimit dhe fotot bashkëlidhur.

Nga provat e administruara konstatohet se leja për zhvillimin e këtij aktiviteti është miratuar nëpërmjet shkresës nr. 273/1 prot., datë 09.01.2025, të Bashkisë Kamëz.

Sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 1, nënpika 1.3, shkronja “c”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, vënia në dispozicion e aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, **për qëllime zgjedhor**, përbën veprimtari publike të ndaluar. Në referim të dispozitave ligjore, provohet se nuk ndodhemi në kushtet e vënies në dispozicion të aseteve publike për qëllime zgjedhore.

Sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj z. Rakip Suli, Kryetar i Bashkisë Kamëz, pasi nuk u arrit të provohej shkelja sipas parashikimeve të nenit 91, pikat 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 91, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, pika 1, nënpika 1.3, shkronja “c”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj z. Rakip Suli, Kryetar i Bashkisë Kamëz.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI